


**PREZANTIMI I STUDIMIT TË ZONAVE DHE HARTAVE**

Siç ilustron në Figurën 1, gjatë studimit u realizua një analizë e nivelit të lartë e territorit shqiptar me synimin që të gjendeshin zonat e përshtatshme për instalimin e Impianteve të Energjisë së Erës (WPP). Rezultatet e kësaj analize janë dokumentuar në Studimin e Zonave të Erës ([Rel. 19133659.13021 Wind Siting Study FINAL\_ALB.pdf]).



**Figura 1 : Nga të dhënat, në zona të përshtatshmërisë**

**Ky studim identifikoi Zonat e Ndalura në të cilat zhvillimi i WPP nuk konsiderohet i përshtatshëm, po ashtu studimi identifikoi një hartë të përshtatshmërisë ku zhvillimi i WPP konsiderohet i përshtatshëm duke paraqitur dhe shkallën e përshtatshmerise nga E lartë (më e përshtatshme) në E ulët (më pak e përshtatshme). Një përmbledhje shpejguese e studimit, me fokus kryesor tek procesi i hartëzimit ilustron në figurën e mëposhtme (Numrat e figurës, sipas referimit në Raportin e Studimi të Zonave)**

---

## MBLEDHJA E TË DHËNAVE DHE PËRPUNIMI

Duke përdorur një analizë vendimarrëse shumëkriterëshe, të bazuar në të dhëna GIS të siguruara nga burime publike ndërkombëtare ose nga institutionet publike kombëtare (AZHT, OST dhe ERRE) dhe përpunimin e tyre me modelin GoldSET Spatial, u identifikuan një seri kriteresh mjedisore, sociale e teknike që mundësuan vlerësimin e potencialit të përshtatshmërisë së territorit për zhvillimin e WPP.

## KRITERET E VLERËSIMIT

Analiza konsistoi në hartëzimin e **zonave të ndaluara (kufizimet)** dhe **indiktorët** për zhvillimin e **hartës së Përshtatshmërisë për WPP**. Zonat e ndaluara përfaqësojnë zonë ekstremisht të ndjeshme ose kushte kufizuese natyrore, njerëzore dhe teknike ku mundësia e zhvillimit të WPP është e pamundur teknikisht ose ku ndikimet mjedisore dhe socio-ekonomike të projektit do të ishin të papranueshme. Kufizimet në një model zonimi mbivendosen për të gjeneruar **një hartë të zonave të ndaluara ku zhvillimi i WPP është i papërshtatshëm (Figura 8 dhe Shtojca B)**. Një pjesë e territorit/tokës është zonë e ndaluar edhe në qofte se ndërpritet vetëm nga një kriter kufizues/ndalues.

## ANALIZA E PËRSHTATSHMËRISË

I gjithë terreni që gjendet jashtë zonave të ndaluara është potencialisht i përshtatshëm për zhvillimin e një ferme me erë/eolike. Gjithashtu, terreni paraqet një shkallë përshtatshmërie sipas analizës së Përshtatshmërisë; dhe hartës shumëkriterëshe të shkallëzimit (me nuancën e ngjyrës) që është prodhuar duke kombinuar të gjithë indikatorët e studimit (**Figura 9 dhe Shtojca C**).

Analiza e detajuar për zonat me të përshtatshme (top 20%) sipas zonës dhe shpejtësisë mesatare të erës pasqyrohet në Studimin e Zonave (Shtojca E dhe Shtojca F).

**Harta e Përshtatshmërisë dhe seria e plotë e indikatorëve dhe zonave të ndaluara janë prodhuar dhe në formatin e dokumentave GIS.** Këto produkte janë të disponueshme dhe përdorshme për të identifikuar Zonat e Ndaluar dhe për të ndërmarre analiza me të thelluara për përcaktimin e zonave me të përshtatshme, ku në varesi të shkallës dhe cilësisë së të dhënave egsiztuese të përdorura për këtë studim si dhe kufizimeve përkatëse të studimit, zhvillimi i një Projekti Eolik/Ere do të përmbushë objektivat më të mira të qëndrueshmërisë.